




REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I MINISTRAVE

MINISTRE SHTETI PËR  
MBROJTJEN E SIPËRMARRJES

**Raporti X**  
**mbi trajtimin e ankesave dhe**  
**sugjerimeve të sipërmarrjes**  
**për muajin qershor 2018**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KRYEMINISTRIA MINISTRE SHTETI PËR MBROJTJEN E SIPËRMARRJES

Të nderuar miq sipërmarrës,

Në detyrën e Ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, në përmbushje të misionit të ndërmarrë për përmirësimin e klimës së biznesit në vend, lejomëni të ndaj me ju raportin e dhjetë të trajtimit të ankesave, në kuadër të njoftimeve periodike dhe raportimit mbi punën e kryer gjatë secilit muaj të kaluar.

Si cdo muaj që nga krijimi i këtij institucioni, në emër të transparencës ju raportojmë kërkesat e ardhura nga ju gjatë muajit qershor si dhe zgjidhjen e ndërmarrë nga zyra jonë. Këto kërkesa/ankesa i gjeni në vijim. Gjithashtu gjatë muajit qershor është arritur deburokratizimi dhe dixhitalizimi i mëtejshëm i një serë dokumentesh, duke lehtësuar kështu më tej barrën e cdo sipërmarrësi për t'i paraqitur ato pranë zyrave administrative publike. Dokumentet që gjenerohen tashmë nga sistemi i portalit e-albania janë:

- Vërtetim për pagesën e kontributeve nga subjekti
- Vërtetim statusi (aktiv, pasiv përfshirë datën)
- Vërtetim për pagesë detyrimesh
- Vërtetim xhiro për tre vitet e fundit
- Vërtetim për përgjegjësitë tatimore
- Ekstrakt i thjeshtë
- Ekstrakt historik
- Vërtetim për regjistrim të investitorit
- Certifikatë regjistrimi

Ju lutem vijoni ta konsideroni këtë dokument-raport si vullnet për komunikim intensiv, e sidomos si shteg përmes të cilit të drejtoni cdo shqetësim tuajin.

Mbetem me konsideratë,

Sonila Qato

# Regjistri i ankesave të trajtuara

| Nr.   | Institucioni përgjegjës                   | Data       | Tematika                                                                                                   | Rezultati                                                                   |
|-------|-------------------------------------------|------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------|
| Nr.1  | Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë | 04.06.2018 | Subjekti kërkon zbatimin e vendimit të KKT "Për Miratimin e Lejes së ndërtimit" për objektin hidrocentral. | Trajtuar me zgjidhje, në ndjekje të përfundimit.                            |
| Nr.2  | Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë | 05.06.2018 | Subjekti raporton problematikë me tensionin e lartë dhe si rrjedhojë djegie të makinerive.                 | Trajtuar me sistemim të rrjetit.                                            |
| Nr.3  | Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë | 06.06.2018 | Subjekti raporton ankesë në lidhje mosrespektim të afateve ligjore për dhënie licence.                     | Trajtuar me zgjidhje.                                                       |
| Nr.4  | Ministria e Financave dhe Ekonomisë       | 07.06.2018 | Subjekti raporton ankesë për mosfshirjen e detyrimeve nga sistemi.                                         | Trajtuar me zgjidhje dhe azhornim të sistemit.                              |
| Nr. 5 | DPD Dogana Durrës                         | 07.06.2018 | Subjekti ankohet për aplikimin e referencave në çdoganimin e mallit.                                       | Trajtuar me zgjidhje.                                                       |
| Nr.6  | Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë | 08.06.2018 | Subjekti kërkon përshtatjen e impianteve fotovoltaike në sistemin aktual energjitik.                       | Në proces.                                                                  |
| Nr.7  | Bashkia Lushnje                           | 10.06.2018 | Subjekti raporton moslikuidim të faturave kontraktore.                                                     | Trajtuar me përgjigje.                                                      |
| Nr.8  | Ministria e Financave dhe Ekonomisë       | 10.06.2018 | Problematikë në lidhje me rimbursimin e TVSH-së.                                                           | Në ndjekje nga MFE mbi hartimin e një plani për rimbursimet e prapambetura. |
| Nr.9  | Ministria e Financave dhe Ekonomisë       | 11.06.2018 | Subjekti raporton problematikë me pagesën e sigurimeve si biznes megjithëse është në pension.              | Trajtuar me marrje masash.                                                  |
| Nr.10 | Ministria e Financave dhe Ekonomisë       | 13.06.2018 | Subjekti raporton mosmbyllje në QKR.                                                                       | Trajtuar me përgjigje.                                                      |
| Nr.11 | Ministria e Financave dhe Ekonomisë       | 13.06.2018 | Subjekti raporton një gjobë që duhet të ishte hequr nga sistemi tatimor.                                   | Trajtuar me azhornim të sistemit.                                           |

| Nr.    | Institucioni<br>përgjegjës                               | Data       | Tematika                                                                                                                                                                                 | Rezultati                                               |
|--------|----------------------------------------------------------|------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|---------------------------------------------------------|
| Nr.12  | Ministria e<br>Financave dhe<br>Ekonomisë                | 14.06.2018 | Subjekti depoziton ankesë lidhur me<br>tarifat e përdorimit të rimorkiatorëve në<br>portet e Republikës së Shqipërisë.                                                                   | Trajtuar me përgjigje.                                  |
| Nr.13  | Ministria e<br>Financave dhe<br>Ekonomisë                | 14.06.2018 | Subjekti kërkon rikontrollo tatimor.                                                                                                                                                     | Trajtuar me zgjidhje.                                   |
| Nr.14  | Ministria e<br>Financave dhe<br>Ekonomisë                | 16.06.2018 | Ankesë mbi kohën e pritjes në pikat<br>doganore.                                                                                                                                         | Trajtuar me përgjigje.                                  |
| Nr.15  | Bashkia Tepelenë                                         | 17.06.2018 | Subjekti raporton ankesë për<br>mosmarrjen e dëmshperblimit për<br>permbytjen e biznesit.                                                                                                | Në proces trajtimi.                                     |
| Nr.16  | Ministria e<br>Drejtësisë                                | 18.06.2018 | Subjekti kërkon regjistrimin e<br>kontratave të kalimit të kredisë në<br>sportelet e ADISA.                                                                                              | Trajtuar me zgjidhje.                                   |
| Nr.17  | Bashkia Tiranë                                           | 18.06.2018 | Subjekti kërkon ndalimin e<br>konkurrencës së pandershme me<br>përcaktimin e çmimeve dhe tarifave në<br>shërbimin taksi.                                                                 | Trajtuar me përgjigje.                                  |
| Nr.18  | Ministria e<br>Bujqësisë dhe<br>Zhvillimit Rural         | 19.06.2018 | Subjekti denoncon inspektim<br>tendencioz dhe jo profesional nga ana<br>e AKU.                                                                                                           | Trajtuar me verifikim dhe<br>përgjigje.                 |
| Nr. 19 | DPD<br>Pogradec                                          | 20.06.2018 | Subjekti ankohet për tejzgjatje të<br>procedurave të zhdoganimit.                                                                                                                        | Trajtuar me zgjidhje"                                   |
| Nr.20  | Ministria e<br>Turizmit dhe<br>Mjedisit                  | 21.06.2018 | Subjekti kërkon zbatimin e vendimit<br>Nr.1104 " Për miratimin e kërkesave për<br>parandalimin e shkarkimit të mbetjeve<br>të krijuara nga anijet dhe tepricat nga<br>ngarkesat në det". | Trajtuar me përgjigje<br>positive, në proces ndjekjeje. |
| Nr.21  | Ministria e<br>Mbrotjtjes!                               | 21.06.2018 | Subjekti depoziton ankesë lidhur me<br>procedurat e prokurimit lidhur me mos<br>shpalljen e fituesit.                                                                                    | Trajtuar me përgjigje.                                  |
| Nr.22  | Ministria e<br>Financave dhe<br>Ekonomisë                | 22.06.2018 | Subjekti kërkon rikontroll tatimor.                                                                                                                                                      | Trajtuar me përgjigje.                                  |
| Nr.23  | Ministria e<br>Shëndetësisë dhe<br>Çështjeve<br>Sociale. | 23.06.2018 | Subjekti depoziton ankesë në lidhje me<br>mospërputhjen e detyrimit kontraktor<br>nga Spitali Rajonal Vlorë.                                                                             | Trajtuar me përgjigje.                                  |

| Nr.   | Institucioni përgjegjës                    | Data       | Tematika                                                                                                           | Rezultati                                                                  |
|-------|--------------------------------------------|------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------|
| Nr.24 | Ministria e Turizmit dhe Mjedisit.         | 24.06.2018 | Subjekti raporton problematikë në licensimin e operatorëve turistik.                                               | Trajtuar me përgjigje sqaruese.                                            |
| Nr.25 | Ministria e Financave dhe Ekonomisë        | 25.06.2018 | Subjekti raporton gjobitje të padrejtë dhe kërkon rikontroll tatimor.                                              | Trajtuar me investigimi dhe përgjigje.                                     |
| Nr.26 | Ministria e Financave dhe Ekonomisë        | 27.06.2018 | Subjekti raporton gjobitje të gjeneruar nga sistemi, ndërkohë që aktiviteti është i pezulluar nga mars 2017.       | Trajtuar me zgjidhje.                                                      |
| Nr.27 | Ministria e Drejtësisë                     | 28.06.2018 | Subjekti raporton vështirësi të pajustificuara për zbatimin e vendimit të regjistrimit të pronës pranë ZRPP Lezhë. | Trajtuar me përgjigje.                                                     |
| Nr.28 | Ministria e Financave dhe Ekonomisë        | 29.06.2018 | Subjekti raporton ankesë për mospajisje me vërtetim për shlyerje detyrimesh tek tatimet.                           | Trajtuar me zgjidhje.                                                      |
| Nr.29 | Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural | 29.06.2018 | Subjekti depoziton ankesë për mos zbatim të vendimit të KKT.                                                       | Trajtuar me zgjidhje.                                                      |
| Nr.30 | Ministria e Financave dhe Ekonomisë        | 30.06.2018 | Subjekti dërgon sugjerim në lidhje me paketën e re fiskale.                                                        | Trajtuar me përgjigje.                                                     |
| Nr.31 | Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë  | 30.06.2018 | Subjekti kërkon sjelljen e energjisë elektrike në biznes.                                                          | Trajtuar me përgjigje.                                                     |
| Nr.32 | Ministria e Financave dhe Ekonomisë        | 30.06.2018 | Subjekti raporton ankesë në lidhje me përcaktimin e kriteri të tenderave.                                          | Fushatë e gjerë me Bashkitë në lidhje me procedurat e prokurimeve publike. |
| Nr.33 | Ministria e Financave dhe Ekonomisë        | 30.06.2018 | Subjekti raporton mungesë informacioni mbi gjobitjen për punonjës të padeklaruar.                                  | Trajtuar me përgjigje këshilluese.                                         |
| Nr.34 | Ministria e Financave dhe Ekonomisë        | 30.06.2018 | Subjekti kërkon tjetërsimin e pronës nga arë në truall.                                                            | Trajtuar me zgjidhje.                                                      |

